



EUROPEAN UNION ELECTION OBSERVATION MISSION KOSOVO LEGISLATIVE ELECTIONS 2014

KUMTESË PËR SHTYP:

BE fillon misionin për vëzhgimin e zgjedhjeve në Kosovë

Prishtinë, 21 maj 2014 – Pas ftesës nga Presidentja e Kosovës, Bashkimi Evropian ka themeluar Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë, të caktuara për datën 8 qershor.

Shefi i Misionit, deputeti i Parlamentit Evropian, z. Roberto Gualtieri (Itali), tha sot: “Këto zgjedhje janë edhe një arritje e rëndësishme e zhvillimit të mëtejshëm demokratik të Kosovës. Prania jonë këtu është vazhdimësi e vëzhgimit të zgjedhjeve komunale vitin e kaluar dhe pasqyron zotimin e vazhdueshëm të BE-së për mbështetje të zgjedhjeve transparente, përfaqësuese dhe gjithëpërfshirëse në Kosovë.”

Një ekip qendror, me seli në Prishtinë, i përbërë prej tetë analistësh të BE-së për zgjedhjet, do të përcjellë të gjitha aspektet e procesit të zgjedhjeve për të vlerësuar përputhshmërinë e tyre me legjislacionin e Kosovës si dhe me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Ekipi do ta analizojë kuadrin ligjor, punën e administratës zgjedhore, aktivitetet e fushatës, sjelljen e mediave, votimin dhe numërimin, verifikimin e votave, procesin e ankesave dhe parashtrësive, si dhe shpalljen e rezultateve.

Njëzet vëzhgues afatgjatë do të vendosen në tërë Kosovën për t’i përcjellë zhvillimet në periudhën parazgjedhore dhe pas zgjedhjeve. Në prag të ditës së zgjedhjeve, misionit do t’i bashkohen edhe dyzetedy vëzhgues të tjerë afatshkurtër. Vëzhgimi i ditës së zgjedhjeve gjithashtu mund të mbështetet edhe nga vëzhguesit nga përfaqësimet diplomatike të Shteteve Anëtare të BE-së.

MVZ do të publikojë një deklaratë preliminare për gjetjet fillestare të misionit në një konferencë për shtyp në Prishtinë pak kohë pas ditës së zgjedhjeve. Raporti përfundimtar do të publikohet disa javë pas shpalljes së rezultateve përfundimtare.

MBEVZ realizon veprimtarinë e tij në mënyrë të pavarur nga institucionet e tjera të BE-së në Kosovë, duke përfshirë Zyrën e BE-së në Kosovë, Përfaqësuesin Special të BE-së në Kosovë dhe përfaqësimet diplomatike të Shteteve Anëtare të BE-së.

*Pyetjet e mediave duhet të drejtohen tek: Sarah Crozier, Zyrtare për Media dhe Komunikim me Publikun,
+386 49 761 007– sarah.crozier@eueomkosovo2014.eu*

MISIONI I BE-SË PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE NË KOSOVË

Hoteli Swiss Diamond, Prishtinë
www.eueom.eu/kosovo2014
info@eueomkosovo2014.eu